

ARSIMI PROFESIONAL
KURRIKULA
Bërthamë

Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë

Niveli 3 dhe 4 i Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës
Shkalla 5 dhe 6 e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës
Niveli I dhe II i Arsimit Profesional
Klasat 10, 11 dhe 12

I. Parathënie

Kurrikula bërthamë për profilin Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, klasat 10, 11 dhe 12.

- 1. Njoftime të përgjithshme për profilin Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, klasat 10, 11 dhe 12.**
 - a. Struktura e shkollimit dhe certifikimi.
 - b. Kërkesat e pranimit të nxënësve.
 - c. Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe të punësimit.
 - d. Qëllimet e përgjithshme të shkollimit.
 - e. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve.
 - f. Kompetencat profesionale të nxënësve.
- 2. Plani mësimor i profilit Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, klasat 10, 11 dhe 12.**
- 3. Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë**
- 4. Përshkruesit e moduleve profesionale**
 - a. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 10-të
 - b. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 11-të
 - c. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 12-të

II. Kurrikula bërthamë për profilin Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, klasat 10, 11 dhe 12

1. Njoftime të përgjithshme për profilin Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, klasat 10, 11 dhe 12

a) Struktura e shkollimit dhe certifikimi.

Arsimimi në profilin mësimor **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë** trajtohet në kuadrin e shkollimit të mesëm të lartë dhe ofrohet në shkollat profesionale dhe në qendrat e kompetencës me dy nivele me kohëzgjatje 3 vite mësimore (kl.10, 11 i takojnë nivelit të parë dhe klasa e 12-të i takon nivelit të dytë). Nxënësit të cilët e përfundojnë nivelin e parë (niveli i tretë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) mund të pajisen me certifikatë dhe e fitojnë të drejtën për të vazhduar në nivelin e dytë (niveli i katërt sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve). Në përfundim të këtij niveli nxënësit fitojnë diplomën me titullin Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë dhe mund të integrohen në tregun e punës dhe/ose të vazhdojnë arsimimin e tyre të mëtutjeshëm post-sekondar..

Ky dokument përmban kurrikulën bërthamë të profilit mësimor **Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë** të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe është i strukturuar në:

- A. Lëndë të kulturës së përgjithshme (programet e tyre jepen në një dokument të veçantë të Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT), të cilat synojnë formimin e përgjithshëm të nxënësve.
- B. Modulet profesionale, modulet specifike të profesionit teoriko-praktike (përshkruhen në këtë dokument). Këto module synojnë përgatitjen e nxënësve me kompetencat profesionale të nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës.

b) Kërkesat e pranimit të nxënësve.

Shkollimin për Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë mund ta ndjekin të gjithë të rinjtë dhe të rejat, që kanë përfunduar me sukses arsimin e detyruar nëntëvjeçar dhe zotërojnë aftësi shëndetësore (mendore dhe fizike) të mjaftueshme për të kryer shkollën e mesme.

Në raste të veçanta, kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta sesa kapacitetet reale të shkollave profesionale, MASHT-i përgatitë udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

Programet e arsimit të mesëm të lartë profesional janë të hapura për personat që kanë kryer arsimin e detyrueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjet. Përgjashtimisht, personat deri në 24 vjet mund t'i regjistrojnë programet e arsimit të mesëm të lartë profesional me aprovimin e këshillit të mësimdhënësve të shkollës në pajtim me dispozitat e MASHT, të cilat rregullojnë kushtet dhe kriteret për regjistrimin e nxënësve dhe ndjekësve të shkollave të mesme profesionale.

c) Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe të punësimit

Arsimimi në profilin Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë trajtohet në kuadrin e shkollimit të mesëm profesional. Pas përfundimit të shkollimit nxënësi fiton diplomën profesionale me titull Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, dhe ka mundësi të integrohet në tregun e punës apo shkollim të mëtejshëm në arsimim post sekondar. Nxënësit të cilët kalojnë me sukses testin e maturës, u lëshohet certifikatë dhe u mundësohet vazhdimi i studimeve në arsimin e lartë.

Përshkrimi i punës:

Profili - Bashkëpunëtori Profesional i Infermierisë do të ketë një tërësi kompetencash profesionale të cilat do t'i shërbejnë atij/asaj në realizimin më efikas të kompetencave të përgjithshme dhe integrimin e mëtejshëm në shoqëri dhe në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Kështu:

Bashkëpunëtori Profesional i Infermierisë do të jetë i aftë që sipas përshkrimit të profesionistit mjekësor të vendos të sëmurin në dhomë dhe në shtrat; të përkujdeset për pozitën dhe higjienën personale të tij (të sëmurit aktiv dhe pasiv); të zbatojë rregullat e mbrojtjes personale dhe të mjedisit.

Ai/Ajo do të plotësojë, mbajë dhe ruaj dokumentacionin e të sëmurit; përcjellë shenjat vitale tek I sëmuri; të marrë mostrën e gjakut dhe materialin tjetër për analiza plotësuese; të shpërndajë terapinë sipas përshkrimit të mjekut; të asistojë mjekun gjatë kontrollit të sëmurit; të përgatisë dhe asistojë të sëmurin gjatë realizimit të teknikave diagnostike; të kujdeset për të sëmurët me sëmundje të brendshme (ku do që është duke ofruar shërbime infermierore) sipas specifikave të sëmundjes dhe të asistojë gjatë menaxhimit të rasteve emergjente.

Ai/Ajo do të zbatoj rregullat organizative të punës në repartin kirurgjik duke asistuar profesionistin mjekësor gjatë ndaljes së gjakderdhjes, aplikimit të antishok-terapisë, metodave të imobilizimit të pjesëve të ndryshme të trupit, përpunimit kirurgjik të plagëve dhe intervenimit kirurgjik; gjatë reanimacionit para dhe pas operativ si dhe menaxhimit të komplikimeve të hershme dhe të vonshme pasoperative.

Ai/Ajo do të zbatoj rregullat organizative të punës në repartin e sëmundjeve infektive sipas specifikave të repartit duke izoluar të sëmurët infektiv varësisht nga natyra e infeksionit; të aplikojë masat mbrojtëse personale dhe të mjedisit punues; të bashkëpunojë në realizimin e planit organizativ të vaksinimit, aplikimit të serumeve të të sëmurët me sëmundje infektive; të përkujdeset për të sëmurët me sëmundje infektive varësisht nga lloji i infeksionit.

Ai/Ajo do të përkujdeset për fëmijët e posalindur duke I dalluar fëmijët e lindur para dhe pas terminit, me anomali të lindura apo lëndime gjatë procesit të lindjes; të zbatojë procedurat profilaktike me qëllim të parandalimit të infeksioneve më të shpeshta të posalindurit.

Ai/Ajo do të përkujdeset ndaj gruas, shtatzënës dhe lehonës gjatë trajtimit të inflamacioneve akute dhe kronike të organeve gjenitale; të këshillojë gruan për mirëmbajtje të higjienës personale gjatë shtatzënive normale dhe toksikozave gravidare; të këshillojë gruan në zgjedhjen e mjeteve dhe metodave kontrceptive.

Ai/Ajo do të përkujdeset për të sëmurët me çrregullime neurologjike dhe psikike duke përfshirë të sëmurët me sëmundje vaskulare dhe gjendje komatoze; të sëmurët me çrregullime psikike dhe sëmundje të vartësisë.

Bashkëpunëtori Profesional i Infermierisë, për të realizuar kompetencat e përcaktuara duhet të ketë njohuri themelore të Ndërtimit dhe funksionit të organizmit, Edukimi shëndetësor dhe Parandalimit të infeksionit, Kujdesit Shëndetësor, Shëndetit dhe sëmundjeve të njeriu,

Kirurgji me Përkujdesje, Gjinekologji me Obstetrikë, Etikës në shëndetësi, Shëndeti dhe Sëmundjet të fëmijët dhe Neuropsikiatri me Kujdes.

d) Qëllimet e përgjithshme të shkollimit

Qëllimi kryesor i shkollimit të lëmit shëndetësor është zhvillimi i personalitetit të nxënësve për t'u inkuadruar në një shoqëri demokratike si qytetarë aktiv e kompetent, si dhe për t'u angazhuar në punën e mëtejshme gjithnjë në ndryshim. Sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi janë dhe zhvillimi të nxënësi i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t'u zhvilluar individualisht nga pikëpamja emocionale, intelektuale dhe profesionale.

Për të realizuar këto qëllime, është e nevojshme që shkolla profesionale t'u krijojë nxënësve:

- Mundësi për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë shprehite dhe qëndrimet e mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e trajnimit profesional të mëtejshëm;
- Kushte për të njohur dhe zbatuar rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kureshtjen intelektuale dhe vlerat morale;
- Kushte për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- Mbështetje për të zhvilluar format e bashkëpunimit dhe të besimit të ndërsjellë nëpërmjet përvojës së punës praktike;
- Mundësi për t'u njohur me zhvillimet perspektive të profesionit të tyre, të para këto në kontestet e integritimit evropian.

Kompetencat e fituara nga nxënësit në përfundim të shkollimit

e) Kompetencat e përgjithshme

Ndjekja e shkollimit në profilin Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë do të zhvillojë të nxënësi një tërësi kompetencash të përgjithshme, të cilat do t'i shërbejnë atij në përvetësimin me efektivitet të programit mësimor, zhvillimin në nivelin e kërkuar të kompetencave profesionale dhe integritimin në shoqëri. Kështu nxënësi do të jetë i aftë të:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte, me shkrim dhe me gojë, për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme (përfshirë dhe ato të kompjuterizuara) të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në zgjidhjen e situatave të ndryshme problemore që do të ndeshë në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të manifestojë qasje të një kritike konstruktive ndaj zhvillimeve profesionale, personale dhe shoqërore.
- Të nxitë potencialin e tij të brendshëm për kërkim të vazhdueshëm në drejtim të zgjidhjeve të reja, më efektive dhe më eficiente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale dhe globale.

- Të manifestojë guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll në ushtrimin e veprimtarive të tij në kontekstin e pavarësisë në vendimmarrje.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë e vullnetin për një të nxënë që zgjat gjithë jetën.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të bëjë vlerësime dhe vetëvlerësime nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet.

d) Kompetencat profesionale

Me përfundimin e suksesshëm të shkollimit trevjeçar në Profilin mësimor “Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë”, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrtojë këto kompetenca profesionale:

- Bashkëpunon në planifikimin dhe menaxhimin e kujdesit për të sëmurët
- Ofron kujdes infermieror, trajtim dhe këshillim për të sëmurët bazuar në planin e kujdesit të përcaktuar nga profesionistët mjekësor
 - Zbaton teknikat e dezinfektimit dhe sterilizimit
 - Përgatitë të sëmurët dhe asiston profesionistin shëndetësor për trajtime mjekësore dhe Adminstrimin e medikamenteve sipas përshkrimit
 - Monitoron gjendjen e të sëmurëve dhe raporton profesionistin shëndetësor
 - Zbaton planin organizativ të punës në shërbimet shëndetësore dhe realizon detyrat e Parapara nga personeli shëndetësor
 - Zbaton rregullat e dokumentimit në infermieri
 - Përditëson informacionin mbi gjendjen e të sëmurëve dhe trajtimin e marrë
 - Përdorë drejtë aparatet, pajisjet dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tyre
 - Zbaton parimet për mbrojtjen e shëndetit dhe dhënien e ndihmës së parë në raste emergjente
 - Zbaton rregullat për mbrojtje personale dhe të mjedisit punues

Funksionet e detyrueshme për profesionin – Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, sipas Standardit të profesionit janë si në vijim:

- Përkujdeset për të sëmurin, mjetet, aparatet dhe pajisjet në institucionet shëndetësore
- Zbaton masat për parandalimin e infeksionit
- Mbështetë profesionistin mjekësorë në trajtimin e të sëmurëve me sëmundje të brendshme
- Bashkëpunon për kujdes dhe monitorimin e vazhdueshëm të sëmurëve në shërbimet kirurgjike
- Kryen masa preventive të standardizuara ndaj të sëmurëve me sëmundje infektive
- Monitoron gjendjen shëndetësore të fëmijëve të posalindur dhe të sëmurë
- Përkujdeset dhe këshillon gruan, shtatzënë dhe lehonë në shërbimet gjinekologjike
- Vepron në përputhje me udhëzimet mjekësore për të sëmurët me sëmundje neuropsikiatrike
- Punon sipas parimeve etike dhe profesionale

2. Plani mësimor i profilit Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, klasat 10, 11 dhe 12

Nr	Lëndët e përgjithshme dhe modulet profesionale	Niveli I		
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
A.	Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	16 (560)	13 (455)	11 (352)
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	3 (105)	3 (105)	3 (96)
2	Gjuhë angleze	2 (70)	2 (70)	2 (64)
3	Gjuhë e huaj e dytë	1 (35)	1 (35)	
4	Matematikë	2 (70)	2 (70)	2 (64)
5	Edukatë fizike dhe shëndeti	2 (70)	2 (70)	2 (64)
6	Fizikë	1 (35)	1 (35)	
7	Biologji	2 (70)	1 (35)	1 (32)
8	Kimi	2 (70)	1 (35)	1 (32)
9	Psikologji	1 (35)		
B.	Modulet profesionale (Gjithsej)	16 (560)	19 (665)	21 (672)
1	TIK	2+0 2(70)	2+0 2(70)	1+0 1(32)
2	Ndërmarrësi	0	0	1+0 1(32)
3	Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut	3+1 4(140)		
4	Edukimi shëndetësor dhe parandalimi i Infeksionit	2+1 3(105)		
5	Kujdesi shëndetësor	2+4 6(210)		
6	Etika në shëndetësi		1+0 1(35)	
7	Farmakologji me dozologji		1+0 1 (35)	
8	Shëndeti dhe sëmundjet te njeriu I/II		1+3 4(140)	1+3 4(128)
9	Kirurgji me përkujdesje		2+3 5(175)	
10	Kujdesi ndaj të sëmurëve me sëmundje infektive		1+2 3(105)	
11	Shëndeti dhe sëmundjet te fëmijët		1+1 2(70)	
12	Gjinekologji me Obstetrikë			2+5 7(224)
13	Neuropsikiatri me kujdes			1+3 4(128)
14	Mikrobiologji me imunologji			1+0 1(32)
15	Biokimi klinike dhe diagnostikë laboratorike			1+1 2(64)
16	Module zgjedhore	1+0 1(35)	1+0 1(35)	1+0 1(32)
	MZ (nevojat bazë të njeriut dhe dietat)			
	MZ(Ndihma e parë)			
	MZ (Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies)			
	MZ (Emergjencat mjekësore)			
	Gjithsej (A+B)	32 (1120)	32 (1120)	32 (1024)

Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë.

- Përgatitja profesionale e nxënësve realizohet me anë të “moduleve profesionale”, të cilët janë me përmbajtje teorike - praktike. Në Planin mësimor të Kurrikulës bërthamë tregohet lista e moduleve profesionale, të cilët janë të detyrueshëm të zbatohen dhe nuk mund të ndryshohen nga shkollat.
- Modulet profesionale janë të përgjithshme dhe specifike për profilin. Modulet e përgjithshme për profilin Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë janë: Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut; Edukimi shëndetësor dhe parandalimi i infeksionit; Etika në Shëndetësi; Farmakologji me dozologji; Mikrobiologji dhe Biokimi klinike me diagnostikë laboratorike.
- Modulet: TIK dhe Ndërmarrësi janë pjesë e fushës kurrikulare *Jeta dhe Puna*.
- Pjesa zgjedhore – Nxënësit në klasët 10, 11 dhe 12 duhet të kenë më shumë se një modul në dispozicion për zgjedhjen e njërit prej tyre që kanë më shumë interesim ta mësojnë.
- Kurrikula bërthamë përmban “përshkruesit e moduleve profesionale”, të cilët duhet të zhvillohen dhe të detajohen më tej nga vetë mësimdhënësit dhe instruktorët e QK dhe SHMLM. Gjatë përgatitjes së programeve mësimore të hollësishme, mësimdhënësit/instruktorët duhet të kenë parasysh që për çdo modul profesional *Rezultatet Mësimore* dhe *Kriteret e Vlerësimit* të nxënësve janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen prej tyre. Ndërsa, përmbajtjet e rubrikave të tjera të moduleve profesionale janë *rekomandueshme* dhe mund të përshtaten nga vetë mësimdhënësit-instruktorët në përputhje me zhvillimet më të fundit në profesionet përkatëse dhe kushtet konkrete për zbatimin e moduleve.
- Edhe nëse modulet profesionale do të trajtohen nga mësimdhënësi të veçantë, gjatë përgatitjes së programeve mësimore të hollësishme dhe gjatë zbatimit të tyre duhet të ketë një *bashkëpunim* të ngushtë të gjithë ekipit të mësimdhënësve/instruktorëve që trajtojnë modulet profesionale të kualifikimit profesional përkatës.
- Për modulet profesionale, si njësi matëse e ngarkesës mësimore do të përdoret koncepti i *Kredisë*, ku një Kredi është i barazvlefshëm me 10 orë mësimore dhe ku një orë mësimore ka një kohëzgjatje prej 45 minutash.
- Përmbushja me sukses e moduleve profesionale kërkon *integrimin e teorisë me praktikën* e profesionit dhe për këtë parimi i “*të nxënësve duke bërë*” duhet të zbatohet gjerësisht në procesin mësimor.
- Njohja e vazhdueshme e nxënësve me Rezultatet e të Mësuarit që përmbajnë përshkruesit e moduleve si dhe me Kriteret e Vlerësimit përkatës ndihmon në nxitjen e *motivimit* të nxënësve dhe lehtëson përvetësimin e kompetencave profesionale.
- Mësimdhënësit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimore të tilla që të fuqizojnë maksimalisht të nxënësve aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e atyre të kompetencave sociale e profesionale të plota dhe të qëndrueshme.
- Rekomandohet që mësimdhënësit/instruktorët e moduleve profesionale të përdorin metoda mësimore që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe sjelljet dhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. Metoda e *punës në grup* duhet të jetë në themel të organizimit të mësimi teorik dhe praktik për të zhvilluar te nxënësit *kompetencat profesionale*, të nevojshme për të përballuar me sukses vështirësitë që kanë të bëjnë me veprimtarinë e ardhshme

- profesionale, me vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm, si dhe me veprimtarinë shoqërore si qytetar i një shoqërie demokratike.
- Një parim tjetër që duhet të zbatohet nga mësimdhënësit/instruktorët e moduleve profesionale është që të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre. Dhënia e detyrave, puna hulumtuuese dhe studimet e rastit të nxënësve kanë një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm.
 - Rekomandohet që në trajtimin e Rezultateve Mësimore teorike të moduleve të përdoren metoda të tilla si *ligjërata, dhënia e shembujve, zgjidhja e problemit teorik, dhënia e detyrave* etj. Ndërsa, në trajtimin e Rezultateve Mësimore praktike të përdoren kryesisht *demonstrimi nga mësimdhënësi, praktika e mbikëqyrur dhe praktika e pavarur e nxënësve*.
 - Mësimdhënësit/instruktorët që trajtojnë modulet profesionale duhet të respektojnë *individualitetin* e nxënësve duke nxitur përparimin e shpejtë të nxënësve të përparuar dhe duke mbështetur nxënësit e prapambetur me veprimtari mësimore te veçanta.
 - Në kushtet e mungesës së mjediseve reale të punës për punë praktike të nxënësve, rekomandohet që në QK dhe SHMLPM të krijohen *mjedise të simuluarra të punës*.
 - QK dhe SHMLPM duhet të krijojë *lidhje të ngushta me bizneset lokale* që kryejnë veprimtari në kualifikimet profesionale përkatëse, për të mundësuar praktikimin e nxënësve dhe marrjen e informatave për zhvillimet në profesionet përkatëse.
 - Për sa i përket **vlerësimit të nxënësve**, rekomandohet të përdoren metoda dhe instrumente vlerësimi që nxisin krijimin e kompetencave të nxënësve, shmangin subjektivizmin në vlerësim dhe tregojnë arritjet reale të tyre. Me rëndësi është vlerësimi i *vazhdueshëm dhe ai përfundimtar*, ku format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit përzgjidhen apo hartohen nga vetë mësimdhënësit. Duhet të synohet vlerësimi i arritjeve *i bazuar në kriteret* (ku arritjet e nxënësit krahasohen me standardet e paracaktuara) dhe të shmanget sa më shumë të jetë e mundur *vlerësimi i bazuar në renditjen* (ku nxënësit krahasohen me njëri-tjetrin). Metodat dhe instrumentet e vlerësimit që rekomandohen janë: pyetjet - përgjigjet me gojë, pyetjet - përgjigjet me shkrim, detyrat me shkrim, vëzhgimi i veprimtarisë së nxënësve, listat e kontrollit të veprimtarive praktike dhe të produkteve të punës, projekte për vlerësimin etj.
 - *Lista e kontrollit* duhet të jetë instrumenti bazë për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve, të testuara në situata pune reale apo të simuluarra.
 - Mësimdhënësit/instruktorët duhet të përgatisin *Instrumentet e vlerësimit* të nxënësve për çdo Rezultat Mësimor të paraqitur në përshkruesit e moduleve profesionale, duke u bazuar në Kriteret e vlerësimit përkatës.
 - Detyra përfundimtare mbulon të gjitha kriteret e vlerësimit të një RM-je, disa RM-ve apo një moduli.
 - **Verifikimi i brendshëm i vlerësimit** – Metodat e vlerësimit duhet të jenë në funksion të rezultateve mësimore të moduleve dhe kualifikimit përkatës. Vlerësimi duhet të jetë transparent dhe i dokumentuar; secili nxënës duhet të ketë portfolion me dëshmi për aktivitetet për të gjitha llojet e vlerësimit: teste, projekte, prezantime, punën praktike, detyra dhe forma të tjera të cilat ndërlidhen me modulet e kualifikimit. Vlerësuesi (mësimdhënësi, instruktori dhe në raste koordinatori i cilësisë) duhet të ketë portfolion që dëshmon se verifikimi i brendshëm është bërë sipas planifikimit, janë plotësuar të gjitha format e verifikimit dhe vlerësimit si dhe janë respektuar procedurat dhe afatet kohore për informata kthyesë dhe komente për nxënësit. Portfoliot e nxënësve dhe mësimdhënësve duhet të shërbejnë si dëshmi edhe për verifikuesit e jashtëm.

- Në rastin e nxënësve me *aftësi të kufizuara*, mësuesit duhet të përshtatin programet e hollësishme të moduleve profesionale në përputhje me mundësitë fizike të këtyre nxënësve, si dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për zbatim.
- Në përgjithësi, si për procesin mësimor, ashtu edhe për vlerësimin e nxënësve, duhet të synohen forma dhe metoda që e vendosin *nxënësin në qendër* të veprimtarive mësimore dhe e shndërrojnë rolin e mësimit nga një lektor i thjeshtë, në një organizator, mbikëqyrës, nxitës dhe vlerësues i veprimtarisë së nxënësve.

4. Përshkruesit e moduleve profesionale

- a) Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 10-të.**
- b) Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 11-të.**
- c) Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 12-të.**

**Klasa 10,
Programi i moduleve profesionale**

PERSHKRUESI I MODULIT

“NDËRTIMI DHE FUNKSIONI I TRUPIT TË NJERIUT”

Klasa 10

Titulli i Kualifikimit: Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë

Vlera e Kredive të Modullit: 7 Kredi (140 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Niveli i Modullit në Strukturën Arsimore: Niveli I i AP – Klasa 10

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit “Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut”, kl. 10:

RM1: Nxënësi përshkruan dhe identifikon karakteristikat morfologjike dhe funksionale të qelizës dhe indeve

RM2: Nxënësi klasifikon kockat dhe nyjet duke përshkruar funksionin e tyre

RM3: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit muskolor

RM4: Nxënësi matë dhe përshkruan parametrat funksional të sistemit kardiovaskular

RM5: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemeve të organeve

RM6: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e shqisave dhe sistemit nervor

RM1: Nxënësi përshkruan dhe identifikon karakteristikat morfologjike dhe funksionale të qelizës dhe indeve

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:

- Përshkruan rëndësinë që ka njohja e ndërtimit dhe funksionimit të trupit të njeriut për punëtorin e lamisë së shëndetësisë
- Dallon ndërtimin e qelizës dhe indeve të ndryshme
- Shpjegon funksionin e qelizës dhe indeve
- Numëron karakteristikat e lëngjeve trupore
- Përshkruan funksionin e leukociteve, eritrociteve dhe trombociteve
- Identifikon elementet e figuruar të gjakut nën mikroskop
- Përcakton grupet e gjakut dhe përshkruan funksionin e tyre
- Përshkruan fazat e ndërprerjes së gjakderdhjes
- Zbaton rregullat e sjelljes dhe sigurisë në laborator/kabinet

Kushtet e nevojshme:

- Klasë mësimore
- Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe
- Kabinet i anatomisë
- Media didaktike si video projektore, flip chart, katalogë, atlase dhe modele.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Ndërtimi dhe funksioni i qelizës
- Karakteristikat morfologjike dhe funksionale të llojeve të ndryshme të indeve
- Lëngjet trupore
- Vetitë fizike, kimike, përbërja dhe roli i gjakut
- Elementet e figuruar të gjakut (qelizat)
- Grupet e gjakut

<ul style="list-style-type: none"> - Ndërprerja e gjakderdhjes - Rregullat e sjelljes dhe sigurisë në laborator/kabinet 	
<p>Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ndryshimit mes qelizës dhe indeve - Dallimi i gjakut, si ind i lëngët, nga indet tjera kompakte - Identifikimi i qelizave të gjakut - Përcaktimi i grupeve të gjakut - Dallimi i fazave të ndaljes së gjakderdhjes 	
<p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi korrekt gjatë punës në grup - Bashkëpunimi i ngushtë me mësimdhënësin - Mbajtja e rregullt e detyrave dhe shënimeve sipas modeli të dhënë. 	
<p>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</p>	
<p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me shkrim (teste të standardizuara/tradicionale) - Listë – kontrolli për punët në laborator dhe për projektet - Prezantime individuale dhe grupore - Vlerësim i vazhdueshëm i aktivitetit të nxënësit gjatë orës mësimore - Punë seminarike - Detyra përfundimtare 	
<p>Evidentimi i Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit me karakter teorik. - Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura - Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës. - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kritereve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>. 	

<p>RM2: Nxënësi klasifikon kockat dhe nyjet duke përshkruar funksionin e tyre</p>	
<p>Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan ndërtimin e skeletit - Tregon funksionin e skeletit në raport me aktivitetet e nevojshme ditore - Emërton pjesët e skeletit - Përshkruan ndërtimin e skeletit të kokës dhe identifikojë kockat e kafkës - Përshkruan dhe dallon kockat e skeletit të trupit - Identifikon dhe përshkruan ndërtimin e skeletit të anësive - Dallon dhe përshkruan ndërtimin e nyjes dhe funksionin lëvizës të saj - Përshkruan ndërtimin e nyjës së bërrylit, krahut, dorës, gjurit, ijeve dhe boshtit të kurrizit 	
<p>Kushtet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore - Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe - Kabinet i anatomisë - Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, skelet, CD. 	
<p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi dhe ndarja e skeletit - Skeleti i kokës, trupit dhe anësive - Ndërtim i nyjës lëvizëse dhe llojet e lëvizjeve 	

<ul style="list-style-type: none"> - Nyja e bërrylit, krahut dhe dorës - Nyja e gjurit, ijëve dhe boshtit të kurrizit
<p>Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i kockave dhe nyjeve - Krahasimi i funksionit të pjesëve të skeletit dhe nyjeve
<p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi - Komunikimi korrekt. - Bashkëpunimi gjatë punëve në grup
<p>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</p>
<p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje –përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim (teste të standardizuara/tradicionale) - Prezantime individuale dhe grupe - Vlerësim i vazhdueshëm i aktivitetit të nxënësit gjatë orës mësimore - Punë seminarike - Listë kontrolli - Detyra përfundimtare
<p>Evidentimi i Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik - Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>.

<p>RM3: Nxënësi përshkruan dhe identifikon funksionin e sistemit muskolor</p>
<p>Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan ndërtimin dhe formën e muskujve - Përshkruan funksionin fiziologjik të muskulaturës në raport me nevojat ditore - Dalloj muskujt sipas funksionit - Përshkruan forcën që zhvillojnë muskujt gjatë punës - Shpjegon funksionin e muskujve të skeletit - Identifikon, përmes mullazheve, muskujt e caktuar duke përshkruar/skicuar formën, pozitën dhe ngjitjen në kocka - Përshkruan funksionin e muskulaturës së lëmuar - Dallon muskulin e zemrës - Përshkruan funksionin e muskulit të zemrës
<p>Kushtet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore - Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe - Kabinet i anatomisë. - Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, CD
<p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi histologjik i muskujve - Llojet e muskujve dhe karakteristikat e tyre funksionale - Puna dhe forca muskulore - Muskujt e lëmuar - Muskujt e kokës, qafës dhe anësive - Muskuli i zemrës

<p>Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i muskulaturës së lëmuar - Identifikimi i muskujve të skeletit - Dallimi i muskulit të zemrës
<p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi - Komunikimi korrekt. - Bashkëpunimi gjatë punëve në grup
<p>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</p>
<p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje –përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim (teste të standardizuara/tradicionale) - Prezantime individuale dhe grupe - Prezantime individuale dhe grupe - Vlerësim i vazhdueshëm i aktivitetit të nxënësit gjatë orës mësimore - Punë seminarike - Listë kontrolli - Detyra përfundimtare
<p>Evidentimi i Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit me karakter teorik - Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura - Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës. - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kritereve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>.

<p>RM4: Nxënësi matë dhe përshkruan parametrat funksional të sistemit kardiovaskular</p>
<p>Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon ndërtimin anatomik të zemrës - Përshkruan ndërtimin anatomik të enëve të gjakut - Dallon qarkullimin e madh dhe të vogël të gjakut - Përshkruan rolin e shtypjes së gjakut në funksionin normal të organeve - Dallon pulsën arteriale dhe kualitetet e tij - Auskulton tonet e zemrës - Palpon pulsën arteriale - Matë shtypjen e gjakut me sfingomanometër
<p>Kushtet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore - Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe - Kabinete anatomike - Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, CD - Sfingomanometër me stetoskop
<p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anatomia e zemrës dhe enëve të gjakut - Karakteristikat funksionale të muskulit të zemrës (rregullimi i punës së zemrës) - Karakteristikat morfologjike të enëve të gjakut - Qarkullimi sistematik (ligjet e hemodinamikës)

- Shtypja e gjakut, pulsi arterial dhe kualitetet e tij
Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësit:
- Dallimi i veçorive të muskulit të zemrës - Identifikimi i arterieve, venave dhe kapilarëve - Përcaktimi i shtypjes së gjakut - Demonstrimi i matjes së pulsit dhe dallimi i kualiteteve të tij
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:
- Prezantimi - Komunikimi korrekt - Bashkëpunimi gjatë punëve në grup
Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:
Metodat e Vlerësimit:
- Pyetje –përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim (teste të standardizuara/tradicionale) - Prezantime individuale dhe grupore - Vlerësim i vazhdueshëm i aktivitetit të nxënësit gjatë orës mësimore - Punë seminarike - Listë kontrolli - Demonstrim praktik me mjete/instrumente përkatëse - Detyra përfundimtare
Evidentimi i Vlerësimit:
- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik. - Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës. - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i> .

RM5: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemeve të organeve
Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:
- Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e rrugëve të frymëmarrjes - Dallon rrugët e sipërme dhe të poshtme të frymëmarrjes - Përshkruan funksionin e mushkërive - Përshkruan mekanikën e frymëmarrjes - Përshkruan ndërtimin e organeve të tretjes - Dallon funksionin e lukthit, zorrëve të holla dhe zorrës së trashë - Përshkruan metabolizmin e sheqernave, proteinave dhe yndyrave - Përshkruan rëndësinë e rregullimit të temperaturës - Përshkruan ndërtimin e veshkave - Shpjegon funksionin e veshkave dhe formimin e urinës - Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e gjëndërrave endokrine - Shpjegon funksionin e hormoneve - Përshkruan ndërtimin e organeve gjinore (femërore dhe mashkullore) - Shpjegon funksionin reprodutiv të organeve gjinore
Kushtet e nevojshme:
- Klasë mësimore - Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe - Kabinet i anatomisë - Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, CD.

<p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi dhe funksioni i rrugëve të frymëmarrjes - Funksioni i mushkërive dhe pleurës - Mekanika e frymëmarrjes dhe rregullimi neurohormonal - Anatomia e organeve të tretjes - Raportet topografike të organeve të tretjes - Proceset sekretuese dhe tretëse të organeve të tretjes - Metabolizmi i materieve ushqyese - Temperatura dhe rregullimi i saj - Anatomia dhe morfologjia e veshkës - Funksioni i veshkës dhe formimi i urinës - Karakteristikat morfologjike dhe funksionale të gjëndrave endokrine - Veprimi fiziologjik i hormoneve - Karakteristikat morfologjike të organeve gjinore femërore - Karakteristikat e organeve gjinore mashkullore - Fiziologjia e organeve gjinore
<p>Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ndërtimit të organeve të brendshme - Shpjegimi i funksionit të organeve dhe sistemit të organeve
<p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi - Komunikimi korrekt - Bashkëpunimi gjatë punëve në grup
<p>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</p>
<p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje –përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim (teste të standardizuara/tradicionale) - Prezantime individuale dhe grupore - Vlerësim i vazhdueshëm i aktivitetit të nxënësit gjatë orës mësimore - Punë seminarike - Listë kontrolli - Detyra përfundimtare
<p>Evidentimi i Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit me karakter teorik - Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura - Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës. - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kritereve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>.
<p>RM6: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e shqisave dhe sistemit nervor</p>
<p>Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan ndërtimin e sistemit nervor - Shpjegon ndarjen e snq dhe snp - Përshkruan ndërtimin dhe funksioni e palcës kurrizore - Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e nervave periferik - Përshkruan ndërtimin dhe funksionet e syrit, veshit, shqisës së nuhatjes, shijes dhe prekjës

<p>Kushtet e nevojshme</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore - Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe - Kabinet i anatomisë. - Media didaktike si videoprojektor, flipchart, katalogë, atlas anatomik, skelet, CD.
<p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi dhe ndarja e sistemit nervorë - Palca e kurrizit - Truri - Fiziologjia e sistemit nervorë qendrorë (SNQ) - Fiziologjia e sistemit nervorë periferik - Nervat trunoshpinorë - Sistemi nervorë autonom dhe vegjetativ - Sistemi i organeve shqisore - Fiziologjia e shqisave
<p>Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krahasimi i sistemit nervor qendror dhe periferik - Dallimi i palcës së kurrizit - Dallimi i nervave trunoshpinor - Dallimi i funksionit të syrit - Dallimi i funksionit të veshit për dëgjim dhe ekuilibër - Dallimi i funksionit të gjuhës - Dallimi i funksionit të shqisës së prekjes
<p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantim. - Komunikimi korrekt. - Bashkëpunimi i afërt gjatë punës në grupe
<p>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</p>
<p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje – përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim (teste të standardizuara/tradicionale) - Prezantime individuale dhe grupe - Vlerësim i vazhdueshëm i aktivitetit të nxënësit gjatë orës mësimore - Punë seminarike - Listë kontrolli - Detyra përfundimtare
<p>Evidentimi i Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit me karakter teorik - Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura - Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës. - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kritereve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>.

PERSHKRUESI I MODULIT
“TEKNOLOGJI INFORMATIVE”

Klasa 10

Titulli i Kualifikimit: Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë

Vlera e Kredive të Modullit: 3 Kredi (70 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Niveli i Modullit në Strukturën Arsimore: Niveli I i AP – Klasa 10

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit “Teknologji Informative”, klasa 10.

RM1: Nxënësi shpjegon ndërtimin fizik të kompjuterit personal

RM2: Nxënësi instalon sistemin operativ

RM3: Nxënësi konfiguron rrjetin kompjuterik standard

RM4: Nxënësi shfrytëzon internetin

RM5: Nxënësi shfrytëzon softuerin aplikativ

RM1: Nxënësi shpjegon ndërtimin fizik të kompjuterit personal

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:

- Kupton konceptet themelore në teknologjinë informative;
- Përshkruan përdorimin e teknologjisë informative në fusha të ndryshme dhe në shoqëri;
- Përshkruan ndërtimin dhe mënyrën e funksionimit të kompjuterit
- Shpjegon komponentët e brendshme dhe të jashtme dhe mënyrën e funksionimit;
- Identifikon komponentët e brendshme dhe të jashtme të kompjuterit personal;
- Dnemonstron leximin e shënimeve në pajisjet e ndryshme në kompjuterë;
- Liston gjeneratat e ndryshme të kompjuterëve;
- Përshkruan veçoritë dalluese të gjeneratave të kompjuterëve;
- Tregon aplikimin e kompjuterëve në fusha të ndryshme
- Paraqet shkathtësi për masa mbrojtëse në punë;

Kushtet e nevojshme:

- Laboratori
- Tabela
- Projektori
- Kompjuter
- Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogje etj.)
- Listat e të dhënave
- Materiale konkretizimi si: (pllaka amë, katela te ndryshme, furnizuesi i rrymës, procesori, memorie, hard disk etj);
- Qasja në internet etj.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Konceptet themelore në teknologjinë informative
- Përdorimi i teknologjisë informative në fusha të ndryshme
- Ndërtimi dhe mënyrën e funksionimit të kompjuterit
- Komponentët e brendshme dhe të jashtme dhe mënyrën e funksionimit të kompjuterit
- Njësitë hyrëse dhe dalëse të kompjuterit
- Gjeneratat e ndryshme të kompjuterëve
- Veçoritë dalluese të gjeneratave të kompjuterëve
- Aplikimi i kompjuterëve në fusha të ndryshme

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Identifikimi i komponentëve të brendshme dhe të jashtme të kompjuterit personal
- Demonstrimi i leximit të shënimeve në pajisjet e ndryshme në kompjuterë
- Listimi i gjeneratave të ndryshme të kompjuterëve
- Zbatimi i shkathtësive për masa mbrojtëse në punë

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi,
- Bashkëpunimi,
- Diskutim
- Iniciativa për hulumtimin e njohurive të reja,
- Mbledhja dhe përpunimi i informatave
- Të menduarit logjik
- Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve
- Qëndrimi kritik dhe konstruktiv
- Puna në grup
- Punë në dyshe etj.

Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:

Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me shkrim.
- Pyetje - përgjigje me gojë
- Listë kontrolli
- Informata kthyese
- Asistenta e vrojtimit
- Detyra të shtëpisë
- Detyra përfundimtare

Evidentimi i Vlerësimit:

- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik (kombinim i pyetjeve me përgjigje të përputhshme, me përgjigje të shumëfishtë ose me përgjigje të shkurtër)
- Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës (të dallojë pajisjet e jashtme dhe të brendshme, lexoj shënimet në pajisjet e ndryshme, lexoj performansat e kompjuterit, dalloj gjeneratat e kompjuterëve etj).
- Kufiri minimal i kalueshmërisë në *testin me shkrim* është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në *Listën e kontrollit*

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - Numërn sistemet operative - Dalloj sistemet operative - Përkufizon sistemet operative dhe rolin e tyre në sistemin kompjuterik - Përshkruan ndërfaqet (interfejsat) dhe gjuhët e ndryshme komanduese - Demonstron instalimin e sistemeve operative - Zbaton procedurat për formatizimin dhe ndarjen e hard diskut - Punon në nivel bazë me sistemet operative DOS, WINDOWS, UNIX, LINUX 	
Kushtet e nevojshme:	
<ul style="list-style-type: none"> - Laboratori - Tabela - Projektori - Kompjuterë - Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogje, DVD me sisteme operative, softuerët sistemor etj.) - Listat e të dhënave - Qasja në internet etj. 	
Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - Sistemet operative të kompjuterit - Llojet e sistemeve operative - Roli i sistemeve operative në sistemin kompjuterik - Ndërfaqet (interfejsat) dhe gjuhët e ndryshme komanduese - Komandat beç (<i>batch</i>) të thjeshta - Zhvillimin e sistemit operativ 	
Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - Demonstrimi i instalimit të sistemit operativ - Zbatimi i procedurave për formatizimin dhe ndarjen e hard diskut - Puna në nivel bazë me sistemet operative DOS, EËINDOËS, UNIX, LINUX 	
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi, - Bashkëpunimi, - Diskutim - Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja, - Mbledh dhe përpunon informata, - Të menduarit logjik, - Shkathësi në zgjidhjen e problemeve, - Të jetë kritik dhe konstruktiv, - Punë në grup. - Punë në dyshe etj. 	
Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:	
Metodat e Vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me shkrim. - Pyetje - përgjigje me gojë, - Listë kontrolli. - Informata kthyesë - Asistenta e vrojtimit 	

- Prezantime te detyrave të ndryshme
- Detyra përfundimtare

Evidentimi i Vlerësimit: informime për politikat e personelit

- Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit.
- Testi me shkrim, kombinimi i përgjigjeve të përputhshme, zgjidhjeve të shumëfishta
- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura.
- Lista e kontrollit duhet të verifikojë aftësinë e nxënësit që ta dallojë sistemet operative të instaluar, të punojë në nivel bazë në secilin sistem operativ, të instaloj sisteme të ndryshme operative etj.
- Kufiri minimal i kalueshmërisë në *testin me shkrim* është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në *Listën e kontrollit*.

RM3: Nxënësi konfiguron rrjetin kompjuterik standard

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:

- Përkufizon rrjetin kompjuterik
- Kupton të gjitha komponentët kryesore të rrjetit
- Tregon veçoritë e komponentëve të rrjetit
- Shpjegon përparësitë dhe mangësitë e rrjeteve të bazuara në server dhe rrjetat e lidhura ballë-për-ballë
- Shpjegon dallimin në mes konfigurimit pikë me pikë ose shumëpikësh;
- Shpjegon modelet e rrjetave
- Klasifikon mediumet transmetuese të rrjetave
- Demonstron instalimin e rrjetit lokal
- Demonstron konfigurimin e një rrjete standarde për komunikim kompjuterik
- Shfrytëzon administrimin e të dhënave prej një kompjuteri në tjetrin

Kushtet e nevojshme:

- Laboratori
- Tabela;
- Projektori
- Kompjuterë
